



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Seancë plenare e Kuvendit të Kosovës
P- 023
Prishtinë, më 4 qershor 2008, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
4 QRSJOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhezair Murati**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 84 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i parë i Grupit të katërt të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës,
- 1.3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
- 1.4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së auditimit të Kosovës,
- 1.5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi zëvendëskryeministrin, **Ramë Manaj**, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** tha se ky projektligj ka për qëllim të rregullojë sistemin zgjedhor për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Projektligji ka 20 kapituj, 129 nene dhe përmban me sa vijon: financimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve, njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar, si dhe kriteret e pranushmërisë së votës, mirëmbajtjen e listave të votuesve, regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike, përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin dhe funksionimin e Komisionit Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa, organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe të këshillave të zgjedhjeve, rregullat për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rregullat e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikimet financiare, mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat, kodin e mirësjelljes së subjekteve politike, të kandidatëve të tyre dhe të mbështetësve, procedurat e votimit, të numërimit dhe të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve, sanksionet dhe gjobat e ngarkuara për shkeljen e dispozitave të këtij Ligji;

Ky projektligj plotëson të gjitha standardet për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, në bazë të votës së lirë të përgjithshme të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Projektligji, i cili del si obligim nga Propozimi gjithëpërfshirës i presidentit Ahtisari, është në pajtim të plotë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nuk është në kolizion me ligjet e tjera.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në parim.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështet këtë Projektligji, në parim.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se mbështetin, në parim, Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikës së Kosovës, kurse vërejtjet konkret për nenin 110 dhe 111 do t'i paraqesin në Komisionin ad hoc.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deklaroi se mbështetin, në parim, Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikës së Kosovës, ndërsa vërejtjet konkrete lidhur me organizmin e sistemit zgjedhor do t'i paraqesin në Komisionit ad-hoc.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështetin këtë Projektligjin, në parim, ndërsa vërejtjet që i kemi së bashku me grupet e tjera opozitare lidhur me disa ndryshime që duhet të bëhen sa u përket komisioneve komunale zgjedhore, do të kërkojmë nga Komisioni ad-hoc që të merren parasysh.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështetin, në parim, Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, ndërsa vërejte do t'i adresojnë të Komisioni ad-hoc.

Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se e mbështet miratimin e Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në parim, ndërsa pati vërejte konkrete sa u përket neneve 66.3, 110.4, 110.5 dhe nenit 111. 2. a, të cilat do t’ia paraqet Komisionit ad- hoc.

Slobodan Petroviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se mbështet, në parim, miratimin e këtij Projektligjit, kurse vërejtjet dhe sugjerimet do t’i paraqesin në Komisionin ad hoc.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij pprojektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Pushtetit Lokal, **Sadri Ferati**, tha se aktualisht në Kosovë nuk ka ligj të veçantë për zgjedhjet lokale. Deri më tani kjo fushë ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, 2007/27 mbi zgjedhjet komunale.

Qëllimi i Projektligji për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës është organizimi i sistemit të mbajtjes së zgjedhjeve lokale të drejtpërdrejta për anëtarët e kuvendeve komunale dhe kryetarët e komunave.

Ky Projektligj ka gjithsej 31 nene dhe është i ndarë në 19 kapituj, dhe rregullon mënyrën apo sistemin e organizimit të zgjedhjeve lokale, organizmin e strukturave komunale apo shpërndarjen e vendeve në komuna, të drejtën për të votuar, regjistrimin dhe certifikimin, shpenzimet për zgjedhjet lokale dhe të gjitha sferat e tjera që kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale .

Projektligji i përmbushë të gjitha kriteret demokratike që parashihen edhe me konventa ndërkombëtare, prandaj i propozoj Kuvendit që të njëjtin ta miratojë.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Ram Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështet, në parim, Projektligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se e mbështet, në parim, këtë Projektligji ndërsa vërejtjet do t’i paraqesin në Komisionin ad hoc.

Ibrahmi Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha se e mbështet Projektligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, ndërsa vërejtjet do t’i paraqesin në Komisionin ad hoc.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se e mbështesin, në parim, Projektligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, ndërsa vërejtët do t'i paraqesin në Komisionin ad hoc.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se e mbështesin, në parim, Projektligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, ndërsa pati vërejte sa u përket normave për regjistrimin e subjekteve politike, të cilat nuk janë të adresuara përmes këtij projektligji, por edhe sa u përket shërbimeve të tjera të votimit, të cilat duhet të kyçen për strukturat e veçanta si TMK-ja, SHPK-ja.

Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar "7+", tha se e mbështet miratimin e Projektligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, në parim.

Slobodan Petroviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se e mbështet në parim miratimin e këtij Projektligji, ndërsa vërejtjet do t'i japë në Komisionin ad-hoc.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----77,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se ky projektligj është shumë i rëndësishëm sidomos tani në transferimin e kompetencave në sektorin e sistemit bankar dhe atë të institucioneve të sigurimit, i cili sektor deri më tani është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/47 për Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës.

Me këtë projektligj themelohet Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si pasardhëse e Autoritetit të Bankave dhe të Pagesave të Kosovës dhe Autoriteti Qendror Bankar të Kosovës dhe si subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota.

Sipas këtij Projektligji, Banka Qendrore e Kosovës, si organ i pavarur publik do të gëzojë autonomi operacionale dhe administrative dhe do të funksionojë jashtë kornizës së strukturave qeveritare të Kosovës dhe Shërbimit Civil të Kosovës, ashtu siç është e rregulluar në shumicën e shteteve moderne.

Me këtë projektligj ka 70 nene dhe rregullon objektivat kryesore të Bankës Qendrore të Kosovës, siç janë: siguria, pagesat dhe funksionimi i sistemit financiar, format e bashkëpunimit dhe të organizimit të kësaj Banka me institucionet e Kosovës, pastaj rregullon edhe mënyrën e organizimit të brendshëm menaxhues dhe të stafit .

Ky projektligji ka zotimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit buxhetor në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Besa Gaxheri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesin, në parim, këtë Projektligj, ndërsa vërejtjet do t'i paraqesin në Komisionin ad-hoc.

Me qenë se nuk pati diskutime të tjera, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se ky është një ndër Projektligjet që ndërlidhet me statusin final të Kosovës për bartjen e kompetencave nga institucionet ndërkombëtare në ato vendore.

Dispozitat e këtij Projektligji promovojnë standarde më të larta të transparencës, përgjegjësisë dhe ndershmërisë në menaxhimin financiar dhe mbarëvajtjen e administratës publike të Kosovës.

Ky Projektligj ka 9 nene dhe rregullon jo vetëm çështjen e themelimit, por edhe të funksionalizimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe të Zyrës së Auditimit, pastaj kompetencat, mënyrën e mbledhjes së informatave dhe ruajtjen e informatave, kontrollin e Zyrës së Auditimit dhe dispozitat përfundimtare.

Ky projektligj ka zotimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit buxhetor në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, në afatin e kërkuar ligjor.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Me qenë se nuk kishte diskutime, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----82,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, **Fatmir Limaj**, tha se ky projektligj është një ndër ligjet në kuadër të ndërtimit të kuadrit ligjor në fushën e transportit hekurudhor dhe mjaft me rëndësi për zhvillimin e këtij sektori.

Qëllimi i këtij projektligj është të rregullojë bazën ligjore për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hekurudhave në Kosovë sipas standardeve Evropiane.

Ky projektligj ka 37 nene dhe parasheh themelimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, pastaj kompetencat, përgjithësitë, strukturën dhe mënyrën e funksionimit të këtij autoriteti, themelimin e menaxhmentit të hekurudhës, krijimin e Bordit Drejtues, kushtet dhe mënyrën e licencimit dhe inspektimin .

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për hekurudhat e Kosovës, në parim.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se e mbështesin, në parim, Projektligjin për hekurudhat e Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----71,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për hekurudhat e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale